



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS, (KGJK) në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 paragrafi 1 pika 1.15 të Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 30 paragrafi 1 të Rregullores mbi Organizmin dhe Veprimtarin e Brendshme të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në mbledhjen e 194- të, të mbajtur me 7 dhjetor 2017, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Udhëzimi Administrativ Nr.03/2017 për Caktimin e Lartësisë së Shpenzimeve dhe Mënyrës së Pagesës së Dëshmitarëve në Procedurën Penale.
2. Vendimi hyn në fuqi me datë 7 dhjetor 2017.



Nehat IDIRZI,

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës


Kopje e vendimit i dërgohet:

- Kryetarëve të gjykatave të Republikës së Kosovës
- Arkivit



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



Duke u bazuar në nenin 1.8 dhe 1.15 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenin 30 të Rregullores mbi Organizmin dhe Veprimtarinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, nenet 450 pika 2.1 dhe nenit 457 të Kodit Nr.04//L-123 të Procedurës Penale, nxjerr këtë:

UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr. 03/2017

PËR CAKTIMIN E LARTËSISË SË SHPENZIMEVE DHE MËNYRËS SË PAGESËS SË DËSHMITARËVE NË PROCEDURËN PENALE

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

Me këtë Udhëzim Administrativ përcaktohet lartësia e shpenzimeve dhe mënyra e pagesës së dëshmitareve në procedurës penale, në të gjitha Gjykatat/degët e Republikës së Kosovës.

Neni 2

Kompensimi i Dëshmitarit

1. Lartësia e shpenzimeve të dëshmitarëve dhe e pagesës në seanca gjyqësore përcaktohet sipas rregullave të këtij udhëzimi.
2. Dëshmitarët, për dëshminë e dhënë në një proces gjyqësor kanë të drejtë në kompensimin e shpenzimeve si në vijim:
 - 2.1. Kur dëshmitari banon në një largësi deri në 100 km nga gjykata ku është ftuar për të dëshmuar, ka të drejtë të kërkojë vetëm kompensimin e shpenzimeve të transportit.
 - 2.2. Kur dëshmitari banon në një largësi mbi 100 km nga gjykata ku është ftuar për të dëshmuar, ka të drejtë të kërkojë kompensimin e shpenzimeve si më poshtë:
 - 2.2.1. Shpenzimet e transportit;
 - 2.2.2. Shujtë ditore jo më shumë se 10€ (Dhjetë Euro) në ditë;
 - 2.2.3. Shpenzimet e fjetjes, jo më shumë se 30 € (Tridhjetë Euro), për natë.
3. Dëshmitari ka të drejtë në kompensimin e mëditjes së humbur në rast se e dëshmon se punëdhënësi i tij nuk ia kompenson pagën për ditën e humbur.
4. Të dënuarit gjatë mbajtjes së dënimit nuk gëzojnë të drejtën e kompensimit për dëshmitë e dhëna.

Neni 3

Procedura për Kompensimit të dëshmitarëve

1. Dëshmitari i cili jep dëshminë në gjykatë, për kompensimin e tij duhet të sjell dokumentacionin përcjellës:

1.1. Kopjen e letërnjoftimit;

1.2. Dëshminë mbi shpenzimet e transportit:

1.2.1. Bileta ose kupon tatimor për derivate;

1.2.2. Derivati llogaritet 10% e çmimit të tregut të derivatit të naftës për km;

1.3. Dëshminë mbi shpenzimet e fjetjes;

1.4. Dëshminë mbi shpenzimet e ushqimit/shujtës ditore;

1.5. Dëshminë se dita e humbur nuk i kompensohet nga punëdhënësi; dhe,

1.6. Kopjen e kartelës bankare me numër të xhirollogarisë

Neni 4

Formulari për Kompensim

1. Pas përfundimit të seancës Gjykata /Dega është e obliguar që të plotësoj formularin për kompensimin të dëshmitarit (shtojca 1).
2. Formulari duhet të nënshkruhet nga Kryetari i Trupit Gjykses dhe Kryetari i Gjykatës/ Gjyqtari Mbikëqyrës.
3. Në Formular është e domosdoshme që pranë nënshkrimit të jetë i shënuar emri dhe mbiemri i Kryetarit të Gjykatës/ Gjyqtarit Mbikëqyrës dhe Kryetarit të Trupit Gjykses.

Neni 5

Procedura për realizimin e Kompensimit

1. Formularin për kompensim të plotësuar dhe të nënshkruar sipas paragrafëve 4.2 dhe 4.3 dorëzohet te Zyrtari Financiar i Gjykatës / respektivisht Arkatari i Degës .
2. Zyrtari Financiar i Gjykatës /Arkatari i Degës pas kontrollimit dhe verifikimit të të dhënave, përgatitë tabelën përmbledhëse cila nënshkruhet nga Kryetari i Gjykatës/ Gjyqtari Mbikqyrës dhe Administratori/ Ndhmës Administratori .
3. Zyrtari financiar /Arkatari, tabelës përmbledhëse të nënshkruar nga Kryetari i Gjykatës/Gjyqtari Mbikqyrës dhe Administratori/ Ndhmës Administratori, ia bashkangjetn dokumentacionin përcjellës dhe realizon kompensimin e dëshmitarit.

**Neni 6
Zbatimi**

Për zbatimin e drejtë dhe efikas të këtij Udhëzimi Administrativ, do të përkujdesen Zyrtari Financiar i Gjykatës/ arkëtari i Degës dhe Administratori/ Ndhmës Administratori i Gjykatës/ Degës përkatëse.

**Neni 7
Hyrja në fuqi**

Ky udhëzim administrativ hyn në fuqi në ditën e miratimit nga KGJK dhe pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

The seal is circular with the text "REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLICA OF KOSOVO" around the perimeter and "KESHILLI GJYQESOR I KOSOVES - SUPREME COURT OF KOSOVO" in the center. It features a central emblem with a shield and a sun. A signature in blue ink is written over the seal.
Nehat IDRIZI,
Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Prishtinë, më datë 07.12.2017